



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2827/12 prot.,

Datë 11.11.2025

V E N D I M
Nr. 1644/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1569/2025, datë 31.10.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK, me Nipt. M42725802A dhe adresë Rr.Hajdinet, ndërtesa 1, Hyrja 1, Luz I Vogël, Kavajë

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 31.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1569/2025, ku vendosi:

[.....]

1. *Të mbyll çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “XHERI’S COMPANY” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 1188/1 prot., datë 04.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2827/9 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1569/2025 datë 31.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës

shtojcën e datë 04.11.2025 “Modifikim DST (“E hapur e thjeshtuar- mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të njësive administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa tvsh)”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1188/1 prot., datë 04.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2827/9 prot., datë 07.11.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1569/2025 datë 31.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës shtojcën e datë 04.11.2025 “Modifikim DST (“E hapur e thjeshtuar- mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të njësive administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa tvsh)”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kryer modifikimet e dokumenteve të tenderit, në përputhje me vendimin Nr.1569/2025 datë 31.10.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000

(gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

